

VENDIM
Nr. 687, datë 22.11.2017

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT VJETOR
TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE
EKZISTUES ME PËRPARËSI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Metodologjia për llogaritjen e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, përcaktohet në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi. Prodhuesit ekzistues me përparësi janë prodhuesit me përparësi, që, në bazë të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, janë pajisur me certifikatën e pranimi të veprës së centralit elektrik, brenda datës 31 dhjetor 2020.

2. Kriteret ku bazohet metodologjia për llogaritjen e çmimit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, janë si më poshtë:

a) “Referenca në çmimin e tregut të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike”, që përfaqëson çmimin mesatar vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) të bursës së Hungarisë HUPX, ashtu siç publikohet në raportin vjetor të kësaj burse për këtë produkt.

b) “Referenca në normën mesatare e shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit”, që përfaqëson kursin mesatar vjetor të këmbimit nga euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin përkatës.

c) “Bonusi për promovimin e burimeve të rinovueshme”, që merr në konsideratë:

i) normën mesatare të kthimit të arsyeshëm të vlerës së investimeve të burimeve të rinovueshme, reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve me rrjetin energjetik të tensionit të lartë dhe/ose të mesëm;

ii) kostot e shmangura të shërbimit të transmetimit;

iii) kostot e alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit të energjisë nga importi.

ç) “Niveli minimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike”, në çdo rast, nuk do të jetë më i ulët se i çmimit të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë për vitin 2016 për këta prodhues.

d) “Niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike”, në çdo rast, nuk do të jetë më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues.

3. Metodologjia për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është si më poshtë:

Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX DAM), i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh x bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.30 x normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama